



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:126908

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05445710

Ac.nr.330/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, sh.a, (KEDS) me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Clinton” nr.3, Ndërtesa Elektrokosovës, kati II, nr. 5, Distrikti në Prizren, kundër të paditurit Sh(A)D., nga Prizreni, rruga "...", nr. ..., për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.502/18, i datës 09.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit Sh(A)D., nga Prizreni, rruga "...", nr..., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.502/18, i datës 09.12.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.502/18, i datës 09.12.2019, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, sh.a, (KEDS) me seli në Prishtinë-Distrikti në Prizren. Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar të paditurin Sh(A)D., nga Prizreni që paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a. KEDS-me seli në Prishtinë- Distrikti në Prizren, në emër të kompensimit të dëmit, t’ia paguajë shumën prej 1,798.53 €uro, me kamatë vjetore e cila llogaritet për mjetet e afatizuara

mbi 1 vit në bankat komerciale në Kosovë, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe kërkesëpadija e paditëses të refuzohet si e pa bazuar apo i njëjti të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosije.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi me datë 24.04.2018 kundër të paditurit, për kompensimin e dëmit material, me arsyet sikur në padi. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar për shkak të mosbindjes C.nr.502/18, i datës 09.12.2019, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se gjykata të paditurit i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi së bashku me provat e bashkangjitura padisë, të cilin aktvendim i padituri e ka pranuar me dt. 30.01.2019, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjigjes në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj meqë ishin plotësuar kushtet ligjore të parapara me paragrafin 1 pika a), b) dhe c) të nenit 150 të LPK-së, ndërsa në anën tjetër gjykata nuk gjeti ndonjë pengesë ligjore të paraparë me nenin 150 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat do të ndikonin në mos marrjen e këtij aktgjykimi ngase në shkresat e lëndës gjendet aktgjykimi penal i formës së prerë P.nr.2017/2015 datë 05.05.2017, në dispozitivin e të cilit ceket edhe shuma e dëmit të shkaktuar nga i padituri dhe fatura e rikthimit të humbjeve me numër DPZ15HP09174 e datës 11.03.2015, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë si dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t 'paditurit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së, me pretendimin se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin, për faktin se kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar është krejtësisht i qartë, dispozitivi është i kuptueshëm e po ashtu është në përputhje edhe me arsyet e aktgjykimit.

Rrjedhimisht janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara pretendimet ankimore të t 'paditurit për shkelje të dispozitës së nenit 5 të LPK-së me pretendimin se gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar të caktojë seancë gjyqësore, për arsye se referuar shkresave të lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të rregullt gjyqësore i ka dërguar të paditurit aktvendimin për përgjigje në padi me të gjitha provat materiale, duke e njoftuar njëkohësisht edhe për pasojat procedurale në rast të mos ushtrimit të përgjigjes në padi, pra duke i dhënë mundësinë të paditurit që i njëjti ta kundërshtojë kërkesëpadinë e paditëses, mirëpo i padituri nuk e ka shfrytëzuar këtë mundësi që ta kundërshtojë kërkesëpadinë e paditëses apo eventualisht të propozojë ndonjë provë me të cilën do t'i argumentonte pretendimet e tija tani ankimore.

Gjykata e Apelit si gjykatë ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret ka vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 150 paragrafi 1 të LPK-së me të cilën shprehimisht parashihet se: *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrje për dhënien e përgjigjes në padi; b). Po që se themelësia e kërkesëpadiës duhet të del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, nuk duhet të jenë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht”*. Nga shkresat e lëndës rezulton se i padituri kishte pranuar aktvendimin për përgjigje në padi së bashku me padinë dhe provat e bashkangjitura padisë, me dt. 30.01.2019, mirëpo i njëjti nuk ka ushtruar përgjigje në padi duke mos e shfrytëzuar të drejtën e tij që ta kundërshtojë kërkesëpadinë e paditëses dhe të ofroj prova me të cilat do të argumentonte pretendimet e tij.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitura nga i padituri sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk janë të themelta për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare si për bazën juridike të kërkesëpadiës ashtu edhe për lartësinë e saj. Nga Aktgjykimi Penal i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr. 2017/15, i dt. 05.05.2017 i plotfuqishëm nga data 03.07.2017 ka vërtetuar faktin se i padituri në procedurë penale është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPPK-së dhe është dënuar me dënim respektiv. Në atë procedurë këtu i padituri e ka pranuar fajësinë për veprën e ngarkuar e njëkohësisht edhe për dëmin e shkaktuar në shumën prej 1,798.53 Euro, për realizimin e të cilës kërkesë atje e dëmtuara- këtu paditësja KEDS është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Me dispozitën e nenit 14 të LPK-së përcaktohet se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.”* Gjykata e Apelit, e ka pranuar në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë, ngase edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje juridike kontestuese. Në këtë kontekst nuk janë pranuar pretendimet ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që nga gjendja faktike e konstatuar e cila është kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale, ka rezultuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Me dispozitën e nenit 136 të Ligjit nr.04/L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve shprehimisht është përcaktuar: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, ndërsa me dispozitën e nenit 140 të të njëjtit ligj është paraparë se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”* Në kuptim të kësaj dispozite rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Në kuptim të dispozitave të cituara e duke u mbështetur në fakte përcaktuese të provuara me mjete provuese të besueshme siç është aktgjykimin penal e po ashtu edhe fatura rikthimit të humbjeve DPZ15HP09174 e datës 11.03.2015 rezulton se gjykata në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e cituara ligjore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika (d), e lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.330/20, me datë 12.03.2024.

Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka, d.v.